



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:019722

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05396878

KF.nr.597/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “G.A.K.” BI me numër unik identifikues 810242462 dhe seli në rr. “UÇK” në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.S. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, anulim vendimi, objekt kontesti ndëshkim tatimor, vlera e kontestit 875,00 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 08.02.2024, në prani të avokatit të palës paditëse A.S., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “G.A.K.” B.I. me seli në Gjakovë, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.prot.429/21 i datës 23.05.2019, i Administratës Tatimore Të Kosovës me seli në Prishtinë, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 28.01.2022, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin a vendimit nr.429/21 të datës 10.12.2021, me të cilin i është refuzuar ankesa ndaj Vendimit për Lëshimin e Ndëshkimit nr.225/2021 të datës 27.09.2021 të ATK-së. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.02.2024, ka deklaruar se mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të ATK-së Divizionit të ankesave nr. 429/21 të datës 10.12.2021, për shkak se konsiderojnë se ky vendim nuk është i bazuar në gjendjen faktike dhe bazën ligjore me rastin e lëshimit të gjobës

administrative nr.225/21 të datës 27.09.2021 për faktin se gjoba për çështjen të cilën është lëshuar nuk ka bazë ligjore sepse deklarimi i librave online tek e paditura nuk është e rregulluar me ligj, andaj nuk mund të konsiderohet pasqyrë financiare se nuk e parasheh neni 1 par.1.8 i Ligjit 03L/222 për Administratën Tatimor dhe Procedurat. Më tej deklaroi se paditësi të gjitha librat i mban konform nenit 33, 34 të Ligjit mbi të Ardhurat Personale, Tatimit mbi Korporatat dhe TVSh-së. Thekson se Inspektorët gjatë vizitës të bërë tek paditësi nuk kanë konstatuar se paditësi nuk mban libra apo nuk i mban konform legjislacionit, por vetëm cekin se nuk i ka deklaruar online tek e paditura. Tutje ka theksuar se kërkesë për ofrim të librave nga ana e të paditurës, paditësi nuk ka pasur asnjë herë ashtu siç e kërkon Ligji mbi Administratën dhe Procedurat dhe Ligjet Tatimore tjera. Më tuje thekson se në përgjigjen në padi e paditura ka cekur se dorëzimi i librave online bëhet për shkak të zyrtarëve të të paditurës që të kenë qasje më të lehtë në dokumentacionin e tatim paguesit, kjo vërteton se zyrtarët e të paditurës kërkojnë komoditet pa mbështetje ligjore. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura këtë çështje administrative e ka vendosur pa pasur mbështetje ligjore, andaj gjykatës i ka propozuar të bie aktgjykim duke aprovuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe njëherit duke e anuluar vendimin e ATK-së nr.429-21 të datës 10.12.2021, dhe duke e liruar nga ndëshkimi administrativ në shumë prej 875.00 €.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 07.11.2022 ka deklaruar se Administrata Tatimore e Kosovës i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi të paditësit, si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se Vendimi i DA-së nr.489/21 i datës 10.12.2021, ka mbështetje ligjore dhe faktike si në shkresat e lëndës dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, me arsyetim se në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-222 për ATK, si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë librat dhe regjistrimet në pajtim me legjislacionin tatimor. Ftesës për seancë i është përgjigjur me parashtrësën e datës 31.01.2024 me kërkesë që gjykata të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të Ligjit nr.03L-202 për Konfliktin Administrativ, duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë/ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.429/2021 i datës 10.12.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 08.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi i DA nr.429/21 i datës 10.12.2021, ankesa e datës 15.10.2021, vendimi i Zyrës për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative nr.225/21 i datës 27.09.2021, forma për vizitë

nga ATK e datës 02.09.2021, inicimin për procedurën e ndëshkim-gjositje nga Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative të datës 23.09.2021, dhe përgjigja në padi e datës 07.11.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), dhe arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura gjatë vizitës në SIGTAS me datë 02.09.2021, për këtu paditësin, ka konstatuar se paditësi nuk ka deklaruar online librat e shitjes dhe blerjes për periudhën 01.07.2021 dhe ka dërguar raportin në zyrën për ndëshkime (tutje: ZGJONA) e cila me aktvendimin nr.225/2021 këtu paditësit i ka shqiptuar ndëshkimin në vlerë prej 875.00 €. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja të njëjtën e ka refuzuar me vendimin kontestues nr.429/21 të datës 10.12.2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e ndaj të cilit vendim këtu paditësi me padinë e datës 01.02.2022 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave dhe argumenteve të të dyja palëve, ka gjetur se vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës përmban të meta në arsyetimin dhe në bazën ligjore të ndëshkimit, veçanërisht duke mos ofruar arsye të mjaftueshme që lidhin mosdeklarimin online të librave të shitjes dhe blerjes me dispozitat e caktuara ligjore. Kjo përfshin mungesën e një rregulloreje specifike ligjore që detyron deklarimin online të tillë, si dhe interpretimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative në mënyrë që nuk mbështesin ndëshkimin administrativ të vendosur.

Gjykata nga vendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim. Gjykata vlerëson se vendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj i njëjti duhet të anulohet.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në vendimin bazë nr.0859/2021 të datës 31.08.2021, ka theksuar se subjekti afarist këtu paditësi është vizituar nga inspektorët tatimor me datë 02.09.2021 dhe ka konstatuar se subjekti tatimor ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të përcaktuara me nenin 53 par 1 të ligjit 03/L-222, për shkak të mos deklarimit online të librit të shitjes dhe blerjes për periudhën shtatë mujore, ashtu siç ceket në legjislacionin tatimor në fuqi, andaj bazuar në nenin 53, paragrafi 1, të ligjit 03/L-222, ka shqiptuar gjobë në shumë prej 875.00 euro, e i cili vendim është vërtetuar nga Divizioni i Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues nr.429/21 i datës 10.12.2021.

E paditura si në vendimin bazë për ndëshkim administrativ nr.225/2021 të datës 27.09.2021, po ashtu edhe në vendimin kontestues nr.429/21 të datës 10.12.2021, është referuar në nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit për Administratën Tatimor dhe Procedurat me arsyetim se mos-deklarimi i librave të shitjes dhe blerjes nga paditësi konsiderohet si mos-deklarim i pasqyrës së informatave. Më tej ka arsyetuar se Njoftimi i ATK-së i datës 02.02.2017 me titullin “*ATK, edhe me një shërbim të ri elektronik*” me të cilin në mënyrë decisive ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit, deklarues të Tatimit mbi vlerën e shtuar se janë obligues për të deklaruar Librin e Blerjes dhe Shitjes, të cilët sipas njoftimit duhet plotësuar dhe deklaruar në baza mujore nga data 01 deri 20 të muajit vijues, njëkohësisht me deklaratën e TVSH-së, është i bazuar në nenin 15 par 1 të Ligjit nr.03/L-222, përkatësisht nenin 28 par 1 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, duke e konsideruar se me të drejtë është vlerësuar se të njëjtat janë pasqyra të informatave të cilat tatimpaguesi nuk i ka raportuar në ATK edhe pse ka qenë i obliguar, andaj konsideron se ndëshkimi administrativ i lëshuar në vlerë 875.00 € është i bazuar në nenin 53 par.1 të Ligjit 03/L-222.

Gjykata për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar iu referua nenit 1 paragrafit 1.8 të Ligjit 03/L-222, i cili në decidivisht përkufizon se çka konsiderohet Pasqyrë Informatash si në vijim: “ *Pasqyrë informatash - nënkupton: 1.8.1. një pasqyrë vjetore barazimi e tatimit në të ardhura të mbajtur në burim 1.8.2. një raport tremujor për kontribute*

pensionesh të mbajtura në burim dhe të paguara; 1.8.3. një pasqyrë vjetore e blerjeve me shumë se pesëqind (500) euro nga furnizuesit e vetëm; 2 1.8.4. një formular aplikacioni për të autorizuar përdorimin e një pajisje elektronike fiskale; 1.8.5. një kupon i lëshuar nga një pajisje elektronike fiskale; 1.8.6. një faturë tatimore që kërkohet sipas ligjeve të Kosovës që lidhen me TVShnë; 1.8.7. një faturë/kupon i përgatitur me dorë (që nuk plotësohet përmes një pajisje elektronike fiskale); 1.8.8. raporti periodik që kërkohet të dorëzohet në administratën tatimore nga një pajisje elektronike fiskale; dhe 1.8.9. çdo formular i caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm për qëllimin e personave që aplikojnë për numra identifikues tatimor dhe që regjistrohen për qëllime tatimore.”, dhe gjeti se në përkufizimin e lartcitar, nuk janë të përfshira librat e blerjes dhe librat e shitjes e që rrjedhimisht gjykata konstaton se e paditura nuk ka aplikuar saktë dispozitat ligjore kur paditësin e ka shpallur përgjegjës për mos-deklarim të librave i cili mos deklarim nuk mund të interpretohet në kuadër të mos deklarimit pasqyrës së informatave siç kërkohet me nenin 53.

Nga dispozita ligjore e cituar më lart, gjykata konstaton se përfundimi i të paditurës nuk është i drejtë dhe ligjërisht i bazuar. Në këtë drejtim, Gjykata sqaron se ligji i ri, përkatësisht Ligji nr.08/1-257 për administrimin e procedurave tatimore, ndër risitë tjera të inkuorporuar, ka paraparë edhe obligimin për dorëzimin në mënyrë elektronike të librave të blerjes dhe të shitjes e ku sipas nenit 43 par. 3 të ligjit të ri, të gjithë personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe aktivitete tjera, duhet të dorëzojnë në ATK, në mënyrë elektronike librin e blerjes dhe librin e shitjes. Po ashtu në përkufizim të pasqyrës tatimore i ka përfshirë librat e shitjes dhe blerjes. Megjithatë, në mungesë të një rregullimi të tillë ligjor në ligjin aktual, Gjykata konstaton se të paditurës i mungon baza ligjore për shqiptimin e ndëshkimit kontestues nga këtu paditësi për mos deklarim online të librave të blerjes dhe shitjes.

Pretendimin e të paditurës se sipas nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-222 për ATP si dhe nenin 17 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2020 tatim paguesit janë të detyruar ti mbajnë librat dhe regjistrimet në pajtim me legjislacionin tatimor, e të cilin e ka interpretuar se: *Një tatim pagues i cila ka detyrim të paguajë ose të mbajë tatimin nga paga do të krijojë regjistrat e llogarive me shkrim ose në formë elektronike të cilat përcaktojnë detyrimin e tyre për pagesë ose tatimin e mbajtur në paga. Librat dhe regjistrat e posaçëm që do të kërkohen për tu përgatitur dhe mbajtur do të jenë të njëjtë me ata të parashikuar në legjislacionin dhe udhëzimet administrative përkatëse, gjykata e vlerëson si të pabazuar, kjo për faktin se dispozita të cilës e paditura i referohet, përkatësisht nenit 17 të UA nr.15/2020 në paragrafin 1 përcakton se: “ Paragrafi 1 i nenit 13 të Ligjit, kërkon që personi, i cili është i detyruar të paguajë apo mbajë*

në burim tatimin, të krijojë apo mbajë regjistrime të llogarisë, të cilat janë në përputhje me legjislacionin tatimor. Librat dhe regjistrimet, mbahen me shkrim ose në formë elektronike të mjaftueshme për të përcaktuar detyrimin tatimor, për të paguar apo mbajtur në burim. Regjistrimet e llogarisë, janë regjistrime të cilat janë të mjaftueshme për të treguar dhe sqaruar një transaksion biznesi dhe për të shpalosë (me saktësi të arsyeshme) pozitën e tij financiare në çdo kohë. Regjistrimet e llogarive mundësojnë përgatitjen e llogarive, në përputhje me kërkesat e ligjit.” Rrjedhimisht, nga dispozita e cituar nuk mund të vërtetohet se mbajtja e librit në mënyrë elektronike është e obligueshme, pasi që e njëjta nuk i referohet librat me shkrim dhe në formë elektronike, por me ose. Andaj, për gjykatën rregullimi me ose nuk nënkupton një obligim që të njëjtat të mbahen në dy mënyra, por i mundëson tatimpaguesit që së paku të mbaj njërin prej formave të përcaktuara me UA.

Gjithashtu referimi i të paditurës në nenin 15 të UA nr.15/2010, se Drejtori i ATK-së mund të kërkoj nga çdo person që të ofroj informata, në rastin konkret, nuk mund të dëshmohet se informatat janë kërkuar nga tatimpaguesi, meqë siç edhe u cek më lart ka kontradikta midis vendimit të ZGJONA me formën e vizitave të përmbushjes së datës 02.09.2021 dhe vendimit kontestues, ku në vendim të ZGJONA theksohet se pas vizitës tek tatimpaguesi që nënkupton vizitë në selinë e biznesit, ndërsa nga vizita e përmbushjes nënkuptohet se kontrolli është bërë përmes SIGTAS dhe se paraprakisht nuk janë kërkuar informatat nga tatimpaguesi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar duhet anuluar me të cilin rast e paditura në rivendosje duhet të arsyetohet arsyen e vizitës, bazën ligjore për vizitë dhe për shqiptimin e ndëshkimit.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*. Dispozitë sipas të cilës përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj e që rrjedhimisht është e paditura ajo e cila në këtë rast e ka barrën e provës e cila po ashtu është e rregulluar edhe me dispozitën e nenit 7 par. 1 dhe 3të LPK-së.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se.

Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par. 2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi e të cilat vërejtjet janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit neni 43, par 2, të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.597/22, datë 22.02.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.